PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 28.04.2023, e premte me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve.

Seancën e 18-të (tetëmbëdhjetë), e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-610/1 në përbërje prej nëntë pikave.

RENDDITE

1. Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 17- të, të Këshillit të komunes së Zhelinës.
2. Propozim – Vendim për përcaktimin e lartësisë së rregullimit të tokës ndërtimore për ndërtim të objekteve në territorin e komunës së Zhelinës.
3. Propozim – Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.
4. Propizim – Vendime për dhënie pëlqim Planit vjetor për punësim të shkollës fillore komunale ,,Rametulla Ameti'' f.Çiflik, shkollës fillore komunale "Luigj Gurakuqi" f. Zhelinë, dhe shkollës fillore komunale "Pashko Vasa" f. Grupçin, për vitin 2024-të.
5. Propizim – Vendime për miratimin e Llogarisë përfundimtare të shkollave fillore komunale në territorin e komunës së Zhelinës, për vitin 2022-të.
6. Llogaria përfundimatre e Qendrës për zhvillim të rajonit planor të Pollogut për vitin 2022-të.
7. Raporti vjetor për implementimin e programit për zhvillimin e rajonit planor të Pollogut 2021- 2026, për vitin 2022-të.
8. Propozim- Vendim për miratim të Llogarisë përfundimtare të NPP Rusino/Pollog, për vitin 2022-të.
9. Propozim – Vendim për formim të iCARE POLOG.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari pas prezantoi rendin e ditës, hapi diskutim për to.

Fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi, dhe kërkoi që te pika e katërt e rendit të ditës të shtohet edhe Propozim- Vendim për dhënien Pëlqim për punësim në shkollën fillore komunale "Ibrahim Temo" Strimnicë.

Propozimin e këshilltarit Naser, Kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht dhe konstatoi se ky propozim i shtohet pikës së katër të rendit të ditës.

Kryetari i këshillit e hudhi në votim rendin e ditës, u votua unanimisht .

1. Miratimi i proçesverbalit të 17-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

   Kryetari i këshillit meqë nuk pati diskutim për këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

2. Propozim-Vendim për përcaktimin e lartësisë së rregullimit të tokës ndërtimore për ndërtim të objekteve në teritorin e komunës së Zhelinës.

   Hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

   Naser M: Kërkoj që të bëhen ndryshime te Zona 1, bëhet fjalë për zonat industriale sepse shumë pak është dallimi në mes Zonës 1 dhe 2 dhe vazhdojnë Zona 3 dhe 4. Kërkoj shembull nga komunat e tjera për çmimet se mos jemi ne komuna e parë që bënë rritjen e çmimeve. Unë jam kundër rritjes së çmimeve.

Kryetari i këshillit pas diskutimeve këtë pikë e hodhi në votim, ku u votua me 9 vota për, 2 të përmbajtur dhe 5 kundër. Pas numërimit të votave Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pikë kalon.

3. Propozim- Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Para se të bëhet ndryshimi i çmimeve doja të kërkoja llogaridhënie nga Kryetari i komunës për taksat e qytetarëve. Mendoj se këto korrigjime të jenë të arsyeshme. Sa i përketë zonave do të fokusohem te Zona 3 dhe 4, propozojë që këta çmime të reduktohen te këta dy zona me arsyetimin se janë zona që nuk kanë as ujësjellës as ujësjellës as kanalizime.

Më pas fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Propozojë që vetëm te Zona 1 të rritet çmimi në 3500 den, të tjerat mos ndryshojnë.

Më pas fjalën e mori këshilltari Nderim Tairi.

Nderim T: Propozoj që vetëm Zona 4 dhe 5 të ngelen siç kanë qenë ndërsa të tjerat të ndryshojnë ashtu siç kemi ra dakord në mbledhjen e mbajtur.

Këshilltari Bashkim Limani e mori fjalën pas këshilltarit Nderim T.

Bashkim L: Kërkoj që kjo pikë të ngelet për seancën e radhës.

Pas diskutimeve Kryetari i këshillit e mori fjalën.

Kryetari i këshillit: Propozim konkret e kemi propozimin e këshilltarit Naser sepse i ngërthen në vete edhe propozimet e këshilltarve të tjerë që reaguan. Dhe më pas e hodhi në votim, ku u votua me 15 vota për, asnjë kundër dhe 2 të përmbajtur, pas votimit Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pikë u miratua.

4. Propizim – Vendime për dhënie pëlqim Planit vjetor për punësim të shkollës fillore komunale ,,Rametulla Ameti'' f.Çiflik, shkollës fillore komunale "Luigj Gurakuqi" f. Zheline, dhe shkollës fillore komunale "Pashko Vasa" f. Grupçin, për vitin 2024-të.

   Meqenëse për këtë pikë nuk pati diskutim Kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht.

5. Propozim-Vendim për miratimin e Llogarisë përfundimtare të shkollave qendrore fillore komunale në territorin e komunës së Zhelinës.

   Kryetari I këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltarja Elmedina Zeqiri e cila dha sugjerim për administratën komunale që të shihet baza juridike e vendimit .
   Më pas këtë pikë kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 15 vota për, 1 kundër dhe 1 të përmbajtur, konstatoi se kjo pikë kalon.

6. Llogaria përfundimtare e Qendrës për zhvillim të rajonit planor të Pollogut për vitin 2022-të.

   Informacione për këtë pikë dha Sadat Tairi përfaqësues i Qendrës rajonale të Pollogut.
   Më pas Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

7. Raporti vjetor për implementimin e programit për zhvillimin e rajonit planor të pollogut 2021-2026, për vitin 2022-të.

   Meqë nuk pati diskuti Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

8. Propozim-Vendim për miratim të Llogarisë përfundimtare të NPP Rusino/Pollog.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Sa është rritur çmimi i tonit në Rusino? Dhe kompania që operon në komunën e Zhelinës a i dërgon të gjitha mbeturinat në Rusino apo i dërgon edhe diku tjetër?

Sqarime dha përfaqësuesi i Rusinos.

Më pas Kryetari i këshillit e hodhi këtë pikë në votim, u votua unanimisht.

9. Propozim-Vendim për formimin të iCARE POLLOG.

   Sqarime dhe informacione për këtë pikë dha përfaqësuesi i iCARE POLLOGUT.
   Më pas Kryetari I këshillit e hodhi këtë pikë në votim, u votua me 13 vota për, asnjë kundër dhe 4 të përmbajtur, dhe konstatoi se kjo pikë kalon.

   Më pas Kryetar I këshillit Bujar Baftjari e shpalli të mbyllur seancën e 18.

Nr.08-610/2
28.04.2023-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari